



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



KËSHILLI QARKUT SHKODËR

Nr. 102 Prot

Shkodër me 15.04 2024

V E N D I M

Nr. 3, Datë 09.04.2024

“PËR SHITESË PLANI NË BUXHETIN E KËSHILLIT TË QARKUT SHKODËR PËR VITIN 2024”

Këshilli i Qarkut Shkodër, në mbledhjen e tij të datës 09.04.2024, me propozim të Kryetarit të Këshillit të Qarkut Shkodër, pasi dëgjoj materialin e paraqitur nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit “Për shtesë plani në Buxhetin e Këshillit të Qarkut Shkodër për vitin 2024” bazuar në nenin 77 të Ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjin nr. 97/2023 “Per Buxhetin e Vitit 2024”, pikat 1, 2/b të nenit 21 të Ligjit nr. 68/2017 ”Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”, Udhëzimin nr. 9 date 20.03.2018 ”Për procedurat standarte të zbatimit te buxhetit”, shkresat nr. 416/2, datë 23.01.2024 dhe 565/1 datë 31.01.2024 ”Transferim fondesh në ofrimin e shërbimit e përkujdesjes në qarqe dhe bashki” si dhe dhe nr. 807/4, datë 12.02.2024 ”Njoftim“ dhe nr. 807/20, datë 19.02.2024”Transferim fondesh në ofrimin e shërbimit e përkujdesjes në qarqe dhe bashki” të MSHMS, Bazuar edhe ne Rregulloren për Organizimin dhe Funkcionimin e Këshillit të Qarkut Shkodër, konkretisht neni 12,13, dhe 15 i saj, pas relatimit nga zyra e Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit dhe më pas diskutimit nga anëtarët e këshillit u kalua në procesin e votimit ku u Miratua me 17 Vota Pro, 0 Vota Kunder dhe 0 Vota Abstenim,

V E N D O S I:

1. Miratimin e shtesës së planit të buxhetit të Këshillit të Qarkut Shkodër për vitin 2024, Transfertë e Kushtëzuar nga MSHMS, për financimin në ofrimin e shërbimeve të përkujdesit shoqëror rezidencial për persona me aftësi të kufizuara dhe përkatësisht;
 - a. Financim për Shtëpi-Familje Madonnina della Grappa” për vitin 2024 në programin 10430 , Art 6060000, shpenzime korente, shumën 7,465,196 lekë.
 - b. Financim për Qëndrën Ditore “Buzëqeshja e Motër Lezes” ofruar nga Shtëpi-Familje Madonnina della Grappa” për vitin 2024 në programin 10430 , Art

6060000, shpenzime korente, shumën 7,631,283 lekë.

Financim për Shtëpi-Familje 'shtëpia Rregullatore e Bashkësisë Misionarët e Dashurisë Kontemplative' për vitin 2024 në programin 10430 , Art 6060000, shpenzime korente, shumën 7,786,372 lekë

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Këshillit të Qarkut Shkoder .
3. Ky vendim hyn ne fuqi 10 dite pas shpalljes së tij.

KRYETARI

Edmond NDOU

